

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR

2021

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	3
1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.....	4
1.1. Përditësimi dhe Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare	4
1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare	4
1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)	8
2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie	8
2.1. Trajtimi i kërkesave të depozituara për njohje pronësie	8
2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim	9
3. Çështje të ndjekura e të ankmuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre.....	9
4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet	10
4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015	10
4.2. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)	11
4.3. Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.....	12
5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP.....	12
5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së	12
5.1.1. Nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese	12
5.1.2. Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun për periudhën <i>janar-dhjetor 2021</i> janë depozituar 771 kërkesa qytetare, nga të cilat rezultojnë	13
5.1.3. Dokumente të trajtuar nga sektori i Arkivës ATP.....	13
5.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes	14
5.2.1. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2021 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023	14
5.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesa/ankesa të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.....	14
5.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA	15
6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit	16
6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2021 duke u bazuar në 12 mujor (i pa kuadruar nga dega e thesarit)	16
6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për vitin 2021.....	17

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ushtron aktivitetin në zbatim të Ligjit 133/2015 *“Për Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”* si dhe akteve nënligjore VKM nr.221/2016; VKM nr.222/2016 e ndryshuar me VKM nr.765/ 2017; VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766/2017 me VKM nr.1114/2020.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.221, datë 23.3.2016, *“Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave”*, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën janar – dhjetor 2021. Ky raport reflekton punën e ATP-së përgjatë vitit 2021 duke dhënë informacionin për objektivat e arritura gjatë këtij viti.

Me datë 04 shkurt 2021 pranë Gjykatës Kushtetuese u zhvillua seancë plenare me palë kërkuuese Shoqatën Kombëtare *“Pronësi me Drejtësi”*, kundër Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave për shfuqizim si të papajtueshëm me kushtetutën të ligjit 133/2015 dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij.

Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës së shoqatës *“Pronësi me Drejtësi”* duke shfuqizuar nenin 7 pika 2, shkronja *“a”* dhe *“b”* të ligjit 133/2015 si dhe disa pika në Vendimin nr. 223/2016.

Pas zbardhjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese të botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, datë 11.03.2021, Ministri i Drejtësisë ngriti një grup pune me urdhër nr. 309, date 14.04.2021 me qëllim *marrjen e masave, hartimin e një projektligji në zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese*. Grupi i punës në kuadër të zbatimit të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, filloi menjëherë takimet konsultative me pjesëmarrës nga Avokatura e Shtetit si dhe me përfaqësues të Këshillit të Ministrave. Pas diskutimeve dhe opinioneve nga grupi i punës, me datë 08 Qershor 2021, Agjencia e Trajtimit të pronave ka dërguar draftin për diskutim për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit 133/2015 dhe relacionin shoqërues në Ministrinë e Drejtësisë. Në vijim janë zhvilluar takime me përfaqësues të Këshillit të Europës në Tiranë dhe konsulent ligjor, për njohjen me këtë draft dhe për të marrë opinionin e tyre.

Për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie (proces i përfunduar më 23.02.2019) ATP ka proceduar pas përfundimit të afatit për kërkesat e patrajuara mbështetur në pikën 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 133/2015, në të cilin citohet se: *‘Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t’i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji’*.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione *për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore*. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

1. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit

1.1. Përditësimi dhe Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare


Agjencia e Trajtimit të Pronave nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në publikimin e fundit në Buletinin e njoftimeve zyrtare nr.7, datë 23.02.2021 ka vlerësuar ***gjithsej 26 092 vendime*** përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013, vlerësim prej të cilit rezultuan të dhënat si më poshtë:

Gjatë periudhës **janar – dhjetor 2021** Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar punën mbështetur në regjistrat e përditësuar të vendimeve përfundimtare për kompensim dhe publikuar në Buletinin e njoftimeve zyrtare.

Janë përditësuar **11 vendime** që kanë njohur të drejtën e kompensimit si vijon:

- ▶ 9 vendime të publikuara me vlerë pozitive;
- ▶ 1 vendim është hequr nga regjistri për shkak gabimi material;
- ▶ 1 vendim për plotësim dokumentacioni nga subjekti.

Të gjitha përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.



1.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, janë regjistruar pranë sporteleve **107 aplikime** të reja për kompensim financiar / fizik dhe ka vijuar procesi i shqyrtimit të dosjeve të cilat janë depozituar më parë dhe do të trajtohen me vendim. Për aplikimet e bëra, subjektet janë njoftuar për të bërë plotësimet përkatëse të dokumentacionit të munguar si dhe janë dërguar shkresa pranë institucioneve të treta për konfirmim të dokumentacioneve. ATP vijon punën duke shqyrtuar kërkesat të cilat vijnë vetëm nga shërbimet online të institucionit.

Gjatë muajit janar 2021 në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezulton:

- ▶ Janë trajtuar me vendim **6 aplikime**, për të cilat ATP ka vijuar me levrimin e kësteve;
- ▶ Fondi që do të lëvrohet për **6 vendime** në total është **vlera 278,555,501.76 lekë** dhe është lëvruar për këstin e parë vlera **55,711,100.35 lekë**;
- ▶ Për kompensimin me kërkesë të veçantë janë lëvruar këstet e rradhës II, III, IV dhe V për aplikime të bëra në vite, në total **vlera 629,568,910.35 lekë** për **204 aplikime**.

Gjatë periudhës shkurt – dhjetor nuk ka pasur vendimmarrje për kompensim financiar dhe fizik për shkak të vendimit të marrë nga Gjykata Kushtetuese në datë 15 shkurt 2021. Seanca plenare në Gjykatën Kushtetuese u zhvillua me datë 04 shkurt 2021 me palë kërkuuese Shoqatën Kombëtare “Pronësi me Drejtësi”, kundër Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave për shfuqizim si të papajtueshëm me kushtetutën të ligjit 133/2015 dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij.

Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës së shoqatës “Pronësi me Drejtësi”:

“- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të pikave 16/2, 16/4 dhe 18 të VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar.

- Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

- Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për të plotësuar ligjin nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij.

- Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.”

Pas zbardhjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese të botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, datë 11.03.2021, Ministri i Drejtësisë ngriti një grup pune me urdhër nr. 309, date 14.04.2021 me **qëllim marrjen e masave, hartimin e një projektligji në zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese**. Grupi i punës në kuadër të zbatimit të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë, filloi menjëherë takimet konsultative me pjesëmarrës nga Avokatura e Shtetit si dhe me përfaqësues të Këshillit të Ministrave. **Pas diskutimeve dhe opinioneve nga grupi i punës, me datë 08 Qershor 2021, Agjencia e Trajtimit të pronave ka dërguar draftin përfundimtar për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit 133/2015 dhe relacionin shoqërues në Ministrinë e Drejtësisë.** Në vijim u zhvillua një takim me përfaqësues të Këshillit të Europës në Tiranë dhe konsulentë ligjor, ku u ballafaquan mendime për këtë draft paraparak. Aktualisht po punohet për konsolidimin e draftit përfundimtar.

Theksojmë se gjatë periudhës së hartimit të ndryshimeve të ligjit, në ATP, sektori i kompensimit vijoi punën në zbatim të pikës 16/4 të VKM nr. 223/2016 e ndryshuar me VKM 1114/2020, e cila u miratua si rekomandim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Beshiri kundër Shqipërisë, **duke kryer përlllogaritjen e vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit, bazuar me vlerësimin financiar me 10% të zërit kadastral aktual.**


Sipas përlllogaritjeve rezultoi që preken **4141 vendime** dhe do të përfitojnë një vlerë financiare afërsisht **18 Mld** lekë. Vendimet përfundimtare me vlerën e tyre përkatëse do të publikohen në Buletinin Zyrtar sapo të miratohen ndryshimet e propozuara në ligjin 133/2015.

Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në 31 dhjetor 2021, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ekzekutuar **794 vendime** me një vlerë prej **7,842,824,600.14 lekë** (Vlera e kompensimit financiar plus

Vlera e llogaritur për kompensim financiar të kërkesave të veçanta), nga të cilat **72 vendime** janë mbyllje procedimi, në periudhat si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1,826,870,845 lekë** (një vlerë prej **1,805,417,553 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **21,453,292 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **2,056,845,314 lekë** (një vlerë prej **1,959,411,055 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **97,434,259 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1,543,025,978.56 lekë** (një vlerë prej **35,521,553 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **1 507 504 425, 56 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1,282,427,619.21 lekë** (një vlerë prej **113,786,500.63 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **1,168,641,118.58 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **855,099,341.17 lekë** (një vlerë prej **49,115,904.46 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **805,983,436.71 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2021** u shpërnda një fond për kompensim financiar me kërkesë të veçantë prej **278,555,501.76 lekë**.

Paraqitje Grafike e fondit financiar të shpërndarë 2016-2021




Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë nga Fondi Fizik i pronave një sipërfaqe prej **713.22 Ha**, me një vlerë financiare prej **1,455,773,530.42 lekë**, si vijon:


- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një sipërfaqe prej **658,899 m² (65.9 ha)** me një vlerë financiare prej **140,425,603 lekë**.
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,575,064 m² (257.5 ha)** me vlere financiare **522,796,506 lekë**.

- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një sipërfaqe prej **568,909 m² (56.9 ha)** me një vlerë financiare prej 116637,991 lekë;
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,319,678.46 m² (231.97 ha)** me një vlerë financiare prej 479,449,812.38 lekë;
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një sipërfaqe prej **1,009,645.20 m² (100.96 ha)** me një vlerë financiare prej 196,463,618.04 lekë.
- ▶ **Gjatë vitit 2021** nuk është shpërndarë sipërfaqe nga fondi i tokës për shkak të pezullimit të ekzekutimit të vendimeve në pritje të ndryshimeve të ligjit 133/2015.

Paraqitje Grafike e fondit fizik të shpërndarë 2016 - 2020



Indikator ATP		Indikator të ATP në zbatim të ligjit 133/2015 periudha 2016-2021							
		2016	2017	2018	2019	2020	2021	Totali 2016-2021	
Kompensimi financiar	Numri i vendimmarrjeve	186	167	16	59	25	0	453	
	Mbyllje procedimi	11	16	2	22	1	0	52	
	Vlera e kompensimit (leke)	1,805,417,553	1,959,411,055	35,521,553	113,786,500.63	49,115,904.46	0		3,963,252,566.09
	Sipërfaqe kompensuar (m ²)	658,899	2,575,064.98	568,909	2,319,678.46	1,009,645.20	0		7,132,196.64
Kompensimi financiar I kërkesave të Vecanta	Numri i vendimmarrjeve	4	12	86	86	75	6	269	
	Mbyllje procedimi	0	0	4	11	5	0	20	
	Vlera financiare e llogaritur	21,453,292	97,434,259	1,507,504,426	1,168,641,118.58	805,983,436.71	278,555,501.76		3,879,572,034.05
	Vlera e kështit të pare	15,852,437	52,748,653	538,001,692	250,593,882.03	175,441,434.10	55,711,100.35		1,088,349,198.48
	Fondi kursyer buxhetit të shtetit	70,416,155	251,197,331	3,010,751,267	1,808,648,186.82	1,252,744,470.90	417,833,252.64		6,811,590,663.36
TOTAL								794	7,842,824,600.14



1.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Pranë ATP-së kanë aplikuar **1138** qytetarë për periudhën janar-dhjetor 2021 dhe rezulton:

- Janë ekzekutuar gjithsej **1338** kërkesa dhe është shpërndarë vlera financiare prej **1,638,071,775.85** lekë.

2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie

2.1. Trajtimi i kërkesave të depozituara për njohje pronësie

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të pa trajtuara (kërkesa të depozituara me ligjet e mëparshme dhe kërkesa të reja sipas ligjit 133/2015). Gjatë periudhës 3 vjeçare të përcaktuar në ligj janë trajtuar me vendim **9 512** kërkesa, ndërsa **6 950** subjekte janë njoftuar të tërheqin dokumentet pranë ATP-së.

Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, gjatë periudhës raportuese **janar – dhjetor 2021**, rezulton se:

- Janë aplikuar **185 kërkesa** nga subjektet në lidhje me tërheqjen e dokumenteve tekniko/ligjor.
- Gjatë kësaj periudhe janë kryer procedurat administrative për **185 kërkesa** për tërheqje dokumentacioni.
- Janë parapërgatuar **328 dosje** me qëllim procesimin e shpejtë të kërkesave për tërheqje dokumentacioni nga subjektet.
- Janë trajtuar **60 kërkesa** në lidhje me analizimin e dokumentacionit tekniko/ligjor, referuar kërkesë padive të përcjella dhe të aplikuara pranë gjykatës së rrethit Tiranë apo apelit Tiranë. Këto vlerësime janë bërë nga grup pune për të ndihmuar procesin e njohjes së pronësisë në gjykatë për t'u ardhur në ndihmë juristëve të Avokaturën e Shtetit dhe përfaqësimit ligjor të ATP-së.

- ▶ Janë kryer **679 kthim përgjigje** subjekteve kërkues dhe institucioneve zyrtare me objekte të ndryshme në kërkesat e tyre.
- ▶ Është realizuar arkivimi i **262 dosjeve** pranë arkivës së ATP-së, sipas ligjit për arkivin.
- ▶ Janë trajtuar **31 kërkesa** të ardhura në portalin e-albania, si dhe nga bashkëqeverisja.

Evidencë e e trajtimit të dosjeve nga ATP

Nr.	Emertimi i procedurave	Numri
1	Nr. total i dosjeve per trajtim	16462
2	Nr. i dosjeve te trajtuara me vendim	9512
3	Nr. i dosjeve te patrajtuara	6950
4	Nr. i njoftimeve per terheqje dosje	6950
5	Kerkesa te subjekteve per terheqje dosje	3873
6	Nr. i dosjeve te terhequra	3657

2.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Në zbatim të ligjit 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, VKM-së nr.222 datë 23.02.1016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” dhe VKM-së nr.770/2014 “Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në Dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **23 368.8 Ha**”, nga ATP për periudhën janar-dhjetor 2021, ka proceduar si vijon:

ATP ka bërë korrespondencë me Agjencitë Shtetërore të Kadastrës përsa i përket statusit juridik të pasurive të evidentuara nga fondi i tokës bujqësore dhe fondi pyjor-kullor, si dhe ka kryer diskutime mbi procesin e kalimit në favor të ATP-së të tokës pyjore – kullorë për t’u përdorur si Fond Kompensimi Fizik.

3. Çështje të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre

ATP është përfaqësuar në dy shkallët e gjyqësorit, civil dhe në atë administrativ, për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, si vijon:

Nga Përfaqësimi Ligjor pranë gjykatave, për periudhën janar – dhjetor 2021, rezulton se:

- ▶ Janë depozituar **732 padi** në të gjitha gjykatat e vendit: në gjykatat e rretheve, në gjykatat e apelit, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në apelin administrativ.
- ▶ Janë mbyllur me vendim **844** çështje;
- ▶ **160** padi janë rrëzuar;
- ▶ **267 padi** kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e çështjes;
- ▶ Janë ushtruar **144 ankime** dhe **98 rekurse**. Total **242**.

Për periudhën janar – dhjetor 2021 pranë ATP-së janë depozituar:

- ▶ Në lidhje me vendimarrjen e ATP-së sa i takon njohjes së të drejtës së pronësisë sipas kushteve **të nenit 29** të ligjit 133/2015, janë administruar **48 padi** dhe rezultojnë:
 - Pranuar 42 padi
 - Rrezuar 16 padi
 - Kthim aktesh ose pushuar 25 padi
- ▶ Në lidhje me vlerësimet financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve **të nenit 19** të ligjit 133/2015, janë depozituar në ATP **14 padi** ku kundërshtohet vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe rezultojnë:
 - Pranuar 22 padi
 - Rrezuar 10 padi
 - Kthim aktesh ose pushuar 4 padi
- ▶ Pas mbylljes së afateve ligjore për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie si dhe vlerësimeve financiare të vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve **të nenit 15** të ligjit 133/2015, janë depozituar **40 padi** në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rezultojnë:
 - Pranuar 27 padi
 - Rrezuar 19 padi
 - Kthim aktesh ose pushuar 7 padi
- ▶ Në lidhje me procedurat sipas kushteve **të nenit 34** të ligjit 133/2015 janë depozituar **304 padi** në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile dhe rezultojnë:
 - Pranuar 89 padi
 - Rrezuar 57 padi
 - Kthim aktesh ose pushuar 117 padi

4. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë kryesisht me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

4.1. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, siç vijon:

- ▶ Kontributi i ATP-së në lidhje me takimin e **13-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”**.
- ▶ Kontributi i parë dhe i dytë institucional me informacione të përditësuar për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021.
- ▶ Kontributin institucional për hartimin e PKIE 2022-2024 ku identifikohen iniciativat ligjore institucionale dhe përputhshmëria me programet analitike të Projekt buxhetit për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024.

- Raportime lidhur me Planin e Masave për rekomandimet e Progres Raportit të vitit 2020, në lidhje me Kapitullin 23.
- Kontributi mbi zbatimin e “Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023: raportimi vjetor 2020, raportimi periodik 3 muhor, 6, muhor, 9 muhor 2021.
- Në kuadër të procedurave mbi zbatimin e “Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, mbështetur në udhëzimet dhe dokumentet strategjike të përcjella nga Ministria e Drejtësisë është përgatitur, miratuar dhe vijon zbatimi sipas planit të masave të “Planit të Integritetit të ATP-së”.
- Kontributi institucional nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas udhëzimeve, për hartimin e dokumentit “Përgjigja Strategjike Kombëtare” në kuadër të Instrumentit të Para Anëtarësimit IPA III, e cila mbulon periudhën kohore 7 vjeçare, 2021-2027.
- Përditësime të informacioneve lidhur me të dhënat të pronës, si një nga prioritetet e qeverisë.
- Raportime javore në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.89, datë 29.02.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë”
- Raportime institucionale në zbatim të ligjit 133/2015 dhe VKM 221/2016 sipas afateve të përcaktuara 3 muhor, 6 muhor, 9 muhor dhe vjetore, për MD, KM, KP.
- Përditësim mbi procedurat dhe kontributin e ATP-se në takimet e “Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore".
- Kontributi i Agjencisë së Trajtimit të Pronave, sipas periudhave raportuese periodike 3 muhor “Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian, KSA dhe JFS” dhe është raportuar pranë MD në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 dhe Kriterin Politik.

4.2. Raportime periodike Muhore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)

Evidence e raportimeve periodike muhor pranë ZOS për periudhën janar – dhjetor 2021

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Aplikime të plota	381	399	364	301	217	257	266	188	248	285	232	560	3698
Aplikime të paplota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Aplikime të mbartura	98	125	152	93	90	77	99	75	90	124	106	224	1353
Total i shërbimeve të levruara	82	78	80	91	85	106	99	72	109	88	96	87	1073
Shërbime të levruara brenda afatit	79	77	63	81	82	5	86	55	102	83	95	82	890
Shërbime të levruara jashtë afatit	3	1	17	10	3	101	13	17	7	5	1	5	183
Plotesim dokumentacioni	0	3	2	9	4	8	1	0	0	0	45	0	72
Ankesa të reja	0	2	4	2	2	1	0	1	1	3	1	1	18
Ankesa të mbartura	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Nr.pergj i ankesave të zgjidhura/shqyrtuara	0	2	4	1	0	1	1	1	1	0	1	0	12

Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	0	1	4	0	0	0	0	1	1	0	0	0	7
Nr.ankesash te zgjidhura/shqyrtuara jashte afatit	0	1	0	1	0	1	1	0	0	3	1	0	8
Aplikime per kompensim nga ALUIZNI	190	172	119	94	34	56	57	34	44	69	23	246	1138
Aplikime prane sektorit te kompensimit Financiar dhe Fizik	11	20	8	12	3	6	10	5	3	3	4	2	87
Aplikime per sherbime pa vendimmarje	180	206	234	193	179	191	199	147	199	212	202	311	2453
Aplikime per kerkesa te vecanta	0	1	3	2	1	4	0	2	1	1	4	1	20

4.3. Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2021**, skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis rezulton:

- ▶ Nr i vendimeve në dosjet e skanuara: 13
- ▶ Nr. I vendimeve të hartografuara: 13

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna me skanimin e dokumenteve plotesuese të vendimeve të skanuara më parë. Janë skanuar gjithsej **3143 dokumenta plotësues** që dalin gjatë procesit të punës, si proces verbale të dosjeve të tërhequra nga subjektet, praktika të tërhequra nga subjektet si dhe vendime të Gjykatës të depozituara me Memo në dosje dhe praktika. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021 nuk ka patur kërkesa nga subjektet për saktësim harte të vendimit përkatës.

5. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP.

5.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së

Për periudhën janar-dhjetor 2021 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave në lidhje me shërbimet që ofrohen ndaj qytetarëve, janë trajtuar:


5.1.1. Nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese

- ▶ **2540** numri i shkresave hyrëse qytetare;
- ▶ **9101** numri i shkresave hyrëse zyrtare;
- ▶ **2465** numri i shkresave me përgjigje qytetare;
- ▶ **2972** numri i shkresave me përgjigje zyrtare.

Evidence e trajtimit të shkresave nga zyra e protokollit janar - dhjetor 2021 sipas 3 mujorëve.

Indikatoret	Treguesit statistikor	Periudha e raportimit				
		3M1	3M2	3M3	3M4	Total 2021
	Numri i shkresave hyrëse qytetare	710	574	516	740	2540

Trajtimi i shkresave në ATP, numri i shkresave hyrëse dhe të trajtuara me përgjigje	Numri i shkresave hyrëse zyrtare	2828	2591	1676	2006	9101
	Numri i shkresave me përgjigje qytetare	600	816	489	560	2465
	Numri shkresave me përgjigje zyrtare	868	755	552	797	2972



5.1.2. Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun për periudhën *janar-dhjetor 2021* janë depozituar **771** kërkesa qytetare, nga të cilat rezultojnë

- ▶ Kërkesë për tërheqje dokumentacioni: 217
- ▶ Kërkesë për plotësim dokumentacioni: 429
- ▶ Kërkesë për informacion: 45
- ▶ Kërkesë për punësim: 13
- ▶ Kërkesë për njohje pronësie :7
- ▶ Kërkesë për metodologji vlerësimi: 6
- ▶ Kërkesë për takim: 5
- ▶ Kërkesë për vërtetim page: 8
- ▶ Kërkesë për kopje dokumentacioni: 41

*Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Mediat dhe Shërbimin Online ka kryer **371 njoftime** për tërheqje kopje dokumentacioni të kërkuara nga subjektet.*

5.1.3. Dokumente të trajtuar nga sektori i Arkivës ATP

Nga sektori i arkivës së ATP-së, në vijim të punës për realizimin e detyrave sektoriale dhe mbështetur në procedurat institucionale, për periudhën janar-dhjetor 2021, rezulton si vijon:

- ▶ Janë trajtuar me përgjigje **1864** kthim përgjigje të adresuara Sektorit të Arkivës nga Institucionet dhe Qytetarët, nga të cilat janë trajtuar me përgjigje **155** kthim përgjigje nga Qytetarët në sistemin on-line **e-albania**.
- ▶ Janë administruar **264** dosje të tërhequra dhe **34** praktika të cilat kanë zbritur në arkivë nga ish-sektorit të shqyrtimit të kërkesave për njohje pronësie dhe hedhur në sistemin Web-GIS.

- ▶ Në zbatim të neneve 42, 43 dhe 44 të Ligjit Nr. 9154 06.11.2003 dhe shkresës nr. 4800 datë 11.06.2021 DPA, në muajin gusht është realizuar përpunimi dhe inventarizimi i dokumentave administrative të viteve 1993-1995 (plane, realizime, korrespondenca, raporte ekonomike, buxhete, investime, urdhra, dok. burimeve njerëzore, etj.)
- ▶ Në zbatim të nenit 30, pika 3 e ligjit nr.133/2015 janë realizuar **271** kopje të vendimeve që kanë njohur të drejtën e parablerjes për Sek/Komp. Fin. Fizik
- ▶ Janë skanuar proces verbalet, kthim përgjigjet (të dosjeve dhe praktikave të tërhequra nga subjektet), vendimet e Gjykatës të depozituara me Memo si dhe plotësime të skanimeve ekzistuese që dalin gjatë procesit të punës të **3143** dosjeve.
- ▶ Janë trajtuar me përgjigje **e mail-et** e adresuar Sek/Arkivës nga bashkëqeverisja dhe Info ATP.
- ▶ Janë trajtuar me përgjigje **13** kthim përgjigje nga Institucionet dhe Qytetarët në sistemin on-line SQDNE.
- ▶ Është realizuar vendosja në dispozicion e dokumentacionit që kërkohet me e-mail zyrtare nga sektorët e tjerë të ATP-së.

5.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes

5.2.1. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2021 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023

Për periudhën janar – dhjetor 2021 nga Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe i denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave nga Grupi i Punës Anti Korrupsion është raportuar, si vijon:

- ▶ Në ATP është 0 (zero) numri i raporteve dhe inspektimeve nga Grupi i Inspektimit të ATP-së;
- ▶ Nuk ka patur asnjë raportim dhe për këtë arsye nuk është bërë asnjë inspektim dhe nuk është marrë asnjë masë;
- ▶ Nuk ka asnjë rast të referuar në Prokurori.

5.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesa/ankesa të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Nga janari deri në dhjetor 2021, janë trajtuar me përgjigje **141 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, nga të cilat:

- ▶ 60 kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e kompensimit financiar/fizik.
- ▶ 9 kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimmarrjes për Njohjen e Pronësisë.
- ▶ 3 Kërkesa/ankesa për Kompensimin me kërkesë të veçantë
- ▶ 32 kërkesa/ankesa e cila ka lidhje me procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale
- ▶ 31 ankesa për Sektorin e Protokollit/Arkivës/Mardhëniet me Publikun
- ▶ 6 kërkesa/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor

Nr	Indikatori	3M1	3M2	3M3	3M4	Total 2021
1	Kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e kompensimit financiar/fizik	8	20	15	17	60
2	Kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimarrjes për Njohjen e Pronësisë	2	1	2	4	9
3	Kërkesa/ankesa për Kompensimin me kërkesë të veçantë	2	0	1	0	3
4	Kërkesë/ankesë e cila ka lidhje procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime in formale	5	9	6	12	32
5	Ankesa për Sektorin e Protokollit/Arkivit/Marrëdhëniet me Publikun	5	7	7	12	31
6	Ankesë për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor	1	0	2	3	6

5.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA

5.3.1.Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e dy shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, nga ATP-ja ka vijuar puna me shërbimet elektronike e bëra publike

Për vitin 2021 nëpërmjet portalit e-albania janë paraqitur **147 aplikime** nga të cilat:

- ▶ 103 aplikime -Ankesë dhe trajtimi i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP
- ▶ 44 aplikime -Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes

5.3.2.Në sistemin e qarkullimit të dokumenteve me nënshkrimin elektronik (SQDNE), janë paraqitur dhe trajtuar 6 aplikime.

Agjencia e Trajtimit të Pronave në kuadër të procesit të implementimit të shërbimeve vetëm online, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”, prej datës 31 Dhjetor 2020 aplikimet sipas udhëzimeve institucionale për shërbimet e mëposhtme mundësohen **vetëm online, nëpërmjet portalit E-Albania:**

- ▶ Aplikim për lëshim kopje dokumentacioni;
- ▶ Aplikim për kompensim financiar dhe fizik;
- ▶ Aplikim për kompensimin e pronave me kërkesë të veçantë;
- ▶ Aplikim për kompensim në ankand;
- ▶ Aplikim për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI);

Evidencë e shkresave/kërkesave/ankesave qytetare të hyra dhe të trajtuara në ATP janar- dhjetor 2021

Emertimi i kerkesave/ankesave qytetare ne ATP	Numri
Nr. i shkresave qytetare nga protokollit	2540
Nr. i kërkesave nga sportelet marr. me publikun	778
Nr. i masave për denoncime kundër korrupsionit	0
Nr. i ankesave nga portali i bashkëqeverisjes	141
Nr. i kërkesë/ankesave nga portali e-Albania	147

6. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit

6.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2021 duke u bazuar në 12 mujor (i pa kuadruar nga dega e thesarit)

ATP për vitin 2021 në paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli, ka realizuar në masën 81%. Arsye për mos plotësimin në masën 100% ka qënë mungesa e organikës. Mungesa e organikës ka ndikuar dhe në indikatorë të tjerë si në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në Mallra dhe shërbime të tjera kemi realizim në masën 57%.

Arsyet e mos realizimit janë:

1. Mos realizimi i prokurimeve nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara për disa mallra të parashikuara për blerje, të cilat janë tonëra, letër, kancelari me bazë letër dhe kancelari të tjera.
2. Mos marrja e sasisë së parashikuar të produkteve të paracaktuara për mbrojtjen ndaj Covid-19, për arsye të pasjes së sasisë së nevojshme si rezultat i marrjes gjatë vitit 2020 të një sasive të konsiderueshme e cila nuk u konsumua përgjatë këtij viti.
3. Kursimi i fondeve të realizuar nga procesi i konkurimit të operatorëve ekonomik në fazën e prokurimit
4. Fond i vënë në dispozicion për Vendimet Gjyqësore për Kompensim është realizuar në masën 21%. Janë likuiduar në mënyrë periodike, dosjet që janë në fazën e likuidimit
5. Fond i pa përdorur është dhe Udhetim i brendshëm, për arsye të pezullimit të ligjit 133/2015, si rezultat i shfuqizimit të disa neneve të tij.

Nr	Emertime	Buxheti 2021	Plani 12 Mujor	Fakti 12 Mujor
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	156,000,000	156,000,000	125,826,172
2	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	28,000,000	28,000,000	20,973,430
3	Mallra dhe shërbime të tjera	40,456,000	40,456,000	23,102,780
4	Transferime korrente të brendshme	1,000,000,000	1,000,000,000	1,000,000,000
5	Transferta për Buxhetet familiare (Fondi Veçante))	244,000	244,000	137,000
6	Shpenz. Për rritjen e aktiveve të Trupëzuara	6,000,000	6,000,000	4,335,804
7	Te Ardhura nga Vkm të tjera		1,394,069	1,394,069
	Totali Buxhetor 1	1,230,700,000	1,232,094,069	1,175,769,255
1	Te Ardhura Jashtë Buxhetore	1,700,000,000	1,700,000,000	1,638,071,775.85
	Totali Jashtë Buxhetore 2	1,700,000,000	1,700,000,000	1,638,071,776
	TOTAL Buxhetore dhe Jashtë Buxhetore (Total 1+Total 2)	2,930,700,000	2,932,094,069	2,813,841,031

6.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, per vitin 2021

Gjatë vitit 2021 janë derdhur në Buxhet të Shtetit të ardhurat nga Tarifa per Aktet – administrative me vlerë 3,049,075 lekë. Janë derdhur ne llogarinë e ATP-së të ardhura te cilat futen ne Bankën e Shqipërisë në Fondin Special të Kompensimit:

- ▶ Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene;
- ▶ Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 70%;
- ▶ Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 50%.

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	3,049,075.00	Periodha 12 Mujore
2	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	1,443,864	Periodha 12 Mujore
3	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 70%	7116101	1,391,325,546.66	Periodha 12 Mujore
4	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 50%	7116102	39,916,492.00	Periodha 12 Mujore
TOTAL			1,435,734,977.84	

Informacioni për të ardhurat është i pa kuadruar nga thesari: Tarifa për Aktet Administrative informacioni është 12 Mujor.

Totali 2 2. Të ardhura nga shitja - tokë, troje e terene	1,443,864	Të ardhura që i shtohen ATP në fondin e kompensimit, në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë rritja e Autorizuar me vleren 1,394,069 lekë. Diferenca prej 49,795 lekë do mbartet vitin 2022
Totali 3+4 3. Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 70% 4. Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 50%	1,431,242,038.66	Të ardhura që i shtohen ATP për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Aluizni), deri tani ne Banken e Shqiperise jane transferuar 1,238,267,020.27 lekë, të cilat janë perdorur per Subjektet qe perfitojne nga ky proces, mbetet per tu transferuar 192,975,018.39 lekë. Fond i cili do mbartet ne vitin 2022

Informacion i shpenzimeve për ALUIZNI dhe Kompensim me raste të veçanta

Totali	2,323,351,786.55	Nr.Subjekteve/ mbyllje procedimi	
Xhirime Aluzini	1,638,071,775.85	1,338	
Raste Te vecanta	685,280,010.70	216	
Kompensim financiar	0.00	0	